

Nr. K4/I29-2 Prot.
Nr. Dok. 202502607/2

Tiranë _27_/_08_/2025

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Lezhë*

Drejtuar: **Drejtues i Parë z. Altin MENA**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë

LEZHË

Kryekomisar z. Oltion GJONI
Shef i Komisarit të Policisë Lezhë

LEZHË

Për dijeni: **Drejtues Madhor z. Ilir PRODA**
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Lezhë nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në datë 04.04.2025.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr.81, datë 25.06.2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Lezhë. Në përbërje të grupit inspektues ishin Hazbi Selita, znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 82/2024 "Për Policinë e

Shtetit”, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit, u takua me Drejtuesin e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, z. Altin Mena, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Drejtuesi i institucionit informoi grupin e inspektimit mbi gjendjen e kushtet, në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë në këtë komisariat dhe informoi për masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar¹, në lidhje me përmirësimin e disa kushteve sipas normave dhe standardeve, për qëndrimin dhe trajtimin e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ndërkombëtare dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, i shoqëruar nga Shefi i Rendit vijoi me inspektimin e ambientit të shoqërimit dhe atij të sigurisë, për evidentimin e kushteve në të cilat janë ndërtuar dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë, plotësimin e kriterëve për ndërtimin e dhomave dhe rregullat që zbatohen nga personeli i shërbimit policor për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore, në lidhje me praninë e sendeve që ekspozojnë dhunë gjatë kryerjes së veprimeve procedurale

¹ Shkresë Nr. K4/I40-2, Prot., datë 31.7.2024 “Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Lezhë”.

për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/të ndaluar/të arrestuar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona.

Nisur nga informacioni i drejtuesve të policisë, por dhe nga inspektimi i kryer në mjediset e sigurisë dhe të shoqërimit në këtë drejtori/komisariat, rezultoi se respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria dhe kushtet infrastrukturore në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, në tërësi ishin sipas kriterëve, normave dhe parametrave teknik të parashikuar në procedurat standarde, që garantojnë sigurinë dhe trajtimin e këtyre personave.

Drejtuesi i institucionit dhe stafi i policisë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues dhe transparentë, gjatë inspektimit në ambientet e këtij komisariati.

Nga informacioni i drejtuesve të komisariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për lyerjen dhe dezinfektimin në mënyrë të vazhdueshme të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaratin e Policisë Lezhë, me qëllim garantimin e kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë në këtë institucion.
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në ambientet e dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Lezhë.
3. Ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin me korrektësi të *“Formularit të Raportit të Shoqërimit”* nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, në zbatim të rregullave të përcaktuara në procedurat standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për eliminimin e lagështirës në ambientet e dhomave të shoqërimit dhe atyre të sigurisë në Komisaratin e Policisë Lezhë².
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar shtimin e dhomave të sigurisë me qëllim respektimin e kriterëve të hapësirës së nevojshme për jetesë për çdo person të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

² Kthim përgjigje të rekomandimit tonë me nr. 11175/1 prot, datë 12.02.2024 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për zëvendësimin e dyerve me profil hekuri, me dyer me profil prej materiali druri në dhomat e shoqërimit sipas parashikimeve të kreut VI, pika 4.e.6.1, e.6.2, në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.
4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për parashikimin e kapaciteteve të dhomave të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, sipas parashikimeve të standardeve të hapësirës, si dhe miratimi me urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
5. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për emërimin e mjekut me kohë të plotë në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar, brenda 12 orëve të vendosjes të këtyre personave në ambientin e sigurisë.
6. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen e tualetit të dhomave të shoqërimit me materialet hidrosanitare dhe vendosjen e bolierit për ngrohje të ujit, i cili është i domosdoshëm për mbajtjen pastër të higjienës personale të personave të shoqëruar në këtë institucion.
7. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, ndalimit/arrestimit për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
8. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e zyrave të përshtatshme për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore veçanërisht me personat e mitur, e pajisur me kamera duke kryer regjistrimin audio dhe video të procesit të marrjes në pyetje.
9. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluari/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokat kryesisht.
10. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisarariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut Tiranë.
11. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes së tyre në komisarariat.
12. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për ndërtimin e ambienteve të ajrimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, për persona të ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se disa rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varen nga njësia vendore, por çdo komisarariat duhet të demonstrojë se ka qenë konsekuent në kërkimin e fondeve, dhe vërejmë me keqardhje të thellë se disa të tjera lidhen me qasjen bashkëpunuese të drejtuesve ndaj rekomandimeve, ndonëse të pranura dhe të përsëritura disa herë nga ana jonë. Ndërkohë, ka edhe rekomandime që kanë ndikim të qenësishëm në jetën e të

shoqëruarve/ndaluarve/arrestuarve të cilat nuk kanë asnjë implikim buxhetor, dhe për pasojë moszbatimi i këtyre të fundit është i pajustificueshëm.

Në përfundim, grupi i inspektimit konstatoi se, në Komisaratin e Policisë Lezhë ishin marrë masa për përmirësimin e standardeve lidhur me garantimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, por vazhdonin të ishin të pranishme edhe disa problematika, të cilat po i parashtrojmë më poshtë:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisaratin e Policisë Lezhë, ishte i ndërtuar pjesërisht sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, dhe procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Sipas informacionit të grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, **rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës**, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte **3 (tre) dhoma shoqërimi**, të cilat ndaheshin në një (1) dhomë shoqërimi për meshkujt madhorë, një (1) dhomë shoqërimi për gra dhe një (1) dhomë shoqërimi për të mitur.

Dhomat e shoqërimit për të rriturit dhe për të miturit në konflikt me ligjin ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme dhe ishin të pajisura me tavolina dhe karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 5x3m² dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral dhe ishin veshur me rrjetë teli. Në dhoma kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Ndërsa sa i përket dhomës së shoqërimit për gratë ishte me përmasa 2x2m dhe nuk plotësonte normat jetësore për persona në konflikt me ligjin siç parashikohet në aktet ligjore në fuqi³. Dhoma ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige për qëndrimin e personave të shoqëruar dhe kishte kapacitetin për qëndrimin e një personi. Gjithashtu, në dhomën e shoqërimit për gra mungonte dritarja që krijon mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral, dhe ndriçimi i vetëm në këtë dhomë ishte ai artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

³ Kreu V1, pika 4, gërma e.1 e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022 ku parashikohet se *“Në njësitë vendore policore ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20 m² secila”*.

MKPT i konsideron të pa përshtatshme kushtet në të cilat ndodhet dhoma e shoqërimit për gra, duke qenë se nuk i plotëson parametrat teknike për ndërtimin e dhomave të shoqërimit, sipas urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde të punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Mjediset e dhomave të shoqërimit ishin të mirëmbajtura dhe pastra nga ana higjieno-sanitare. Brenda në dhomat e shoqërimit ndodheshin tualete për meshkuj, ashtu dhe për femra. Këto ambiente **nuk** ishin të pajisura me materialet e duhura hidrosanitare **dhe mungonin** bolierët për ngrohjen e ujit, të cilët janë të domosdoshëm për mbajtjen pastër të higjienës personale të personave të shoqëruar në këtë institucion. Ndërkohë në dhomat e shoqërimit kishte ujë të rrjedhshëm 24 orë.

Dyert e dhomave ishin me profil hekuri, mbylleshin me çelës nga jashtë dhe kishin bravë të rregullt. Megjithatë, sjellim në vëmendje normat dhe standardet që parashi kohen në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ku parashikohet se: “*Përmasat e dyerve duhet të jenë jo më pak se 1.0 x 2.0 m, prej materiali druri masiv të fortë dhe të staxhionuar (jo prej materiali fibër, kartonë apo tamburatë). Ndërsa dyert e dhomave të shoqërimit për të rritur nga ana e brendshme duhet të përforcohen me një fletë llamarinë, e cila montohet dhe puthitet me sipërfaqen e drurit të derës duke eliminuar/fshehur tehet prerëse të saj.*

Në pjesën e sipërme të dyerve duhet të krijohet një hapësirë me përmasa 60 x 40 cm, në të cilën montohet një xham transparent dhe i armuar (i pa çmontueshëm dhe rezistent/i pathyeshëm ndaj goditjeve me grushte, shkelma, kokë). Hapësira e dritares/sportelit të derës nga ana e korridorit të dhomave sigurohet me një rrjetë teli me shufra me seksion/trashësi 0,6 mm të cilat vendosen në mënyrë vertikale dhe horizontale duke krijuar kuadrate 5 x 5 cm”⁴.

Nga inspektimi i ambienteve të dhomave të shoqërimit, u konstatua se gjendja teknike e godinës ishte e mirë, por kishte prezencë të lagështirës. Ky shqetësim, u evidentua edhe nga stafi i komisariatit, të cilët na informuan se lagështira ishte evidente në të gjithë katin e parë të godinës së komisariatit, por më e theksuar ishte në ambientin e tualeteve dhe në dhomat e shoqërimit, në të cilat kishte rënë suvaja për shkak të saj. Niveli i lagështirës ishte tej normave të pranueshme, dhe si pasojë ka ndikim negativ në jetën dhe shëndetin e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar, si dhe për vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

⁴ Kreu V1, pika 4, gërma e.6. 1, e.6.2 dhe e.6.4 e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

Korridori i këtij ambienti dhe dhomat e shoqërimit ishin të monitoruara me kamera, për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me të shoqëruarit. Afati për ruajtjen e pamjeve filmike ishte 30 ditë.

Në Komisarlatin e Policisë Lezhë gjatë periudhës **01.01.2025** deri më **04.04.2025** ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **189** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit nr. 82/2024, “*Për Policinë e Shtetit*”, ku saktësisht ishin të shoqëruar **168** shtetas madhorë burra, 7 gra dhe 14 të mitur konflikt me ligjin.

Në momentin e inspektimit në zyrat e OPGJ-së ishte i shoqëruar një mitur në konflikt me ligjin, i shoqëruar nga prindërit e tij, i cili po informohej për të drejtat e tij, pa praninë e avokatit mbrojtjes dhe psikologut. Grupi i inspektimit kërkoi informacion OPGJ-së në lidhje me procedurën e intervistimit të të miturit në konflikt me ligjin, ku na informuan se akoma nuk kishte filluar procedura e intervistimit dhe ishin në pritje të psikologut të njoftuar nga ana tyre. Ndërkohë shtetasi i shoqëruar na informoi se kishte rreth 30 minuta që ishte në ambientet e Komisarlatit të Policisë Lezhë dhe pritej të merrej në pyetje nga specialistët/oficerët e policisë gjyqësore. Gjithashtu, personi i shoqëruar nuk paraqiti asnjë ankesë për keqtrajtim nga punonjësit e policisë gjatë shoqërimit të tij në komisarlat.

Për sa më sipër, i mituri në konflikt me ligjin, gëzon të drejtat e parashikuara, jo vetëm në Kodin e Procedurës Penale, por edhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Kështu, në rastet e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të të miturit dhe shoqërimit të tij në komisarlat, detyrimisht njoftohet familja, përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi, psikologu⁵. Në çastin e shoqërimit/ndalimit/arrestimit, të miturve u bëhet i qartë shkaku i kufizimit të lirisë dhe u komunikohen të drejtat dhe garancitë procedurale. Të miturit merren në pyetje nga specialistët e Policisë së Shtetit⁶, pasi janë njoftuar prindërit apo përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi, si dhe psikologu, që do të thotë, se pyetja e të miturit mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor/procedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij⁷.

Në vijim të intervistimit me të miturin në konflikt me ligjin u informuam se nuk i ishte dhënë karta e të drejtave **në formë shkresore, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës** sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në komisarlat. Rekomandimi i MKPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, **duhet t’u jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit**, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 5 orë

⁵ Nenet 18 dhe 19, të ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë penale për të Mitur”.

⁶ Neni 25, i ligjit nr.37/2017, parasheh në mënyrë të hollësishme, detyrimin e organeve kompetente, për marrjen e masave të duhura, për të siguruar, që “personat, të cilët punojnë me të miturit, të kenë njohuritë e nevojshme, ndërgjegjësimin profesional më të lartë për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktime ose dëshmitar”

⁷ Nenin 42, të ligjit nr.37/2017 “ “Kodi i Drejtësisë penale për të Mitur”.

(maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë dhe kanë të drejtën për njoftimin e familjarëve të tyre, të drejtën për qasje me avokat mbrojtës, etj. Aktualisht, karta me të drejtat jepet vetëm në momentin kur i ndaluar/arrestuar merret në pyetje nga OPGJ dhe hyn në dhomat e sigurisë.

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me *“Kartën e të drejtave”* në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisarjat policie. Nëpërmjet *“Kartës së të drejtave”* qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

“Karta e të Drejtave” i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të *“Kartës së të Drejtave”* është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Kjo praktikë është vlerësuar edhe Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues CPT-ja, i cili e përshendeti zhvillimin e kësaj praktike për kartën edhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyrën e pranimit të sigurohen që të shoqëruarit duhet të shkruajnë e lexojnë dhe e kuptojnë përmbajtjen e kartës.

Gjatë inspektimit, u evidentua se ishte krijuar një mjedis i ri i quajtur *“Hapësirë miqësore për fëmijët”*, që shërbente për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të mitur në konflikt me ligjin. Ky ambient, përbëhej nga 3 dhoma të kompletuara me pajisje dhe orënditë e nevojshme për mbrojtjen dhe trajtimin dinjitoz të të miturit, viktimë e një vepr penale, gjatë procesit të hetimit. Por referuar konstatimit më lart, oficerët e policisë gjyqësore vijonin praktikën e marrjes në pyetje në zyrat e tyre, në kundërshtim të hapur me Kreun VI, pika 4, gërma “i” të procedurës standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në strukturën organike të Komisarjatisë të Policisë Lezhë janë 5 specialistë policie, që kryejnë funksionin e OPGJ-së për rastet e hetimit të veprave të rënda penale dhe njëkohësisht ata kryejnë veprimet procedurale të marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar. Në këtë institucion kishte 4 zyra pune të OPGJ-ve dhe nga inspektimi i këtyre zyrave, u gjet një shkop druri, prania e të cilit ekspozonte dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Mbajtja e këtyre sendeve në dhomat e oficerëve të policisë gjyqësore përbën shkelje të rregullave dhe procedurave të punës për administrimin e provave materiale të fiksuara

gjatë procedimeve penale, duke i mbajtur ato në zyrat e punës të pa paketuara/ambalazhuara apo futur në qese për këtë qëllim.

Edhe pse në Komisariatit të Policisë Lezhë, kishte një magazinë me vete e cila shërbente si dhomë e marrjes së provave materiale, sipas informacionit të drejtuesve të komisarariatit provat materiale mbahen në zyrën e OPGJ-ve deri në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë dhe pastaj futen në një qese të etiketuar në këtë ambient⁸.

Gjithashtu, kjo problematikë është trajtuar edhe në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023, i cili ka rekomanduar se: **“Çdo objekt me çështje jo standarde që mund të përdoret për keqtrajtim duhet të hiqet nga të gjitha ambientet e policisë ku personat mund të mbahen ose merren në pyetje. Çdo send i sekuestruar si provë duhet gjithmonë të etiketohet, regjistrohet dhe ruhet në një dhomë të dedikuar”**.

Në katin e parë të Komisarariatit të Policisë Lezhë, ndodheshin 2 zyra të cilat shërbenin si zyrë pune për Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ). Ky ambient ishte i pajisur me tavolinë, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orënditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, por nuk kishte të instaluar kamerat e monitorimit⁹.

Nga inspektimi u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisarariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatit të Policisë Lezhë, ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar në tërësi sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, dhe procedurat standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin nr. 1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ambientet e sigurisë përbëheshin nga 4 dhoma sigurie me kapacitet zyrtar për 6 persona. Konkretisht 2 dhoma me nga 1 (një) person secila dhe 2 (dy) dhoma të tjera me 2 persona, të ndara në dhoma për të rritur, në dhoma për femra dhe në dhoma për të mitur, sipas kërkesës së ligjit nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, dhe procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin nr.1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodheshej një (1) person, në cilësinë e të arrestuarit.

⁸ Neni 215 i Kodit të Procedurës Penale “Vulosja e sendeve të sekuestruara”.

⁹ Kreu VI, Pika 4/g e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Dhomat e sigurisë janë të organizuara në dy ambiente, në ambient qëndrimi dhe në parashkoll, të ndara me njëra-tjetrën me një skarë hekuri dhe derë që mbyllet me çelës, në ambientin për jetesë, si dhe në parashkollin që shërbente për qëndrimin e personave në orare të caktuara dhe për pastrim vetjak.

Të 2 dhomat e sigurisë të pajisura me nga një shtrat, i plotësonin normat dhe parametrat teknike jetësore, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 m², e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe parashkoll me sipërfaqe 4 m².

Ndërsa dy dhomat e tjera të pajisura me dy shtretër, për të arrestuarit/ndaluarit meshkuj madhorë, ndonëse ishin të ndara në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe parashkoll me sipërfaqe 4 m², **nuk** plotësonin kriteret për sipërfaqen e nevojshme për jetesë për dy persona¹⁰.

Nga këqyrja e regjistrit për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, për periudhën 01.01.2025-04.04.2025, ishin evidentuar në këtë regjister 86 persona, nga të cilët saktësisht 83 shtetas madhorë, 1 shtetas të mitur dhe 2 shtetase gra të ndaluar/të arrestuar në konflikt me ligjin.

Referuar këqyrjes së këtij regjistri u evidentua se në disa raste ka pasur situatë të mbipopullimit apo rasteve të personave që flenë në tokë. Grupi i inspektimit konstatoi se në disa dhoma të sigurisë përveç dyshekut të vendosur në krevat, kishte dhe nga një dyshek tjetër, ku në rast të mbipopullimit personat flinin në dyshek të vendosur në tokë, duke përbërë **trajtimit jo dinjitoz të tyre**¹¹.

Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar edhe në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023, i cili ka rekomanduar se: **“Autoritetet shqiptare duhet të marrin masat e nevojshme për të garantuar respektimin e kapaciteteve zyrtare të ambienteve të ndalimit të policisë”**.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla, që mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Çdo dhomë ishte e pajisur me tualete brenda dhe me orenditë e nevojshme për jetesë si krevat, dyshekë, batanije dhe jastëk, të cilat ishin në gjendje të mirë dhe të pastra.

¹⁰ Normat dhe parametrat teknike, jetësore e të sigurisë së dhomave për një të arrestuar/ndaluar janë: Sipërfaqe e përgjithshme jo më pak se 10 metër katror, e cila ndahet në ambient qëndrimi (dhoma) me sipërfaqe 6 m² dhe parashkoll me sipërfaqe 4 m². Lartësia e këtyre ambienteve është jo më pak se 2.5 m.

¹¹ Kreu V, pika 9/ c procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (1 dush me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor. Dushi ishte funksional dhe punonte me sistem qendror.

Larja e batanijeve dhe ndërrimi i materialeve të vjetëruara apo dëmtuara që shërbenin për fjetje në dhomat e sigurisë, kryhej periodikisht sipas një grafiku të miratuar nga struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Policisë Lezhë.

Në ambientet e sigurisë **nuk** kishte sistem ngrohjeje/ftohjeje qendror sipas kushteve klimaterike, sikurse parashikohet edhe në procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, por për periudhën e dimrit institucioni kishte siguruar pajisje elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në rast nevojë. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për përdorim nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Ambienti i sigurisë kishte burim rezervë energjie me gjenerator më vete.

Ambienti i sigurisë kishte një dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku/ndihmësmjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige, por në këtë komisarjat, vazhdonte të ekzistonte mungesa e mjekut të punësuar me kohë të plotë. Sipas informacionit të drejtuesve të komisarjatisë, mjeku është me kohë të pjesshme në institucion.

Mungesa e mjekut/ndihmësmjekut me kohë të plotë është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në ligj dhe në procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, si dhe aktet ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë qartë kryerjen e detyrueshme të vizitës mjekësore brenda afatit 12 orë, nga koha e hyrjes të personave të ndaluar/arrestuar në ambientin e sigurisë. Pavarësisht se i arrestuari nuk kishte ankesë në këtë drejtim, mjeku/ndihmësmjeku duhet të ishte i pranishëm sa herë që ishte e nevojshme apo kërkohej ndihmë mjekësore nga të ndaluarit/arrestuarit.

Kryerja e vizitave mjekësore dhe evidentimi i tyre në kartelë dhe regjistrin përkatës të Komisarjatisë të Policisë¹², janë detyrim ligjor për mjekun/ndihmësmjekun, por dhe për drejtuesit dhe punonjësit e policisë, pasi duhet të garantojnë shërbimin shëndetësor të nevojshëm ndaj këtyre personave, gjatë gjithë periudhës që ata ndodhen në mjediset e policisë.

¹² Kreu II, pika 7, e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

Mekanizmi Kombëtar konstaton në mënyrë përsëritur se mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente dhe si rrjedhojë pasojat mund të jenë të rënda.

Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023, i cili ka rekomanduar se: ***“Autoritetet shqiptare të marrin masat e nevojshme për të siguruar që dispozitat e procedurave standarde që kanë të bëjnë me ekzaminimin fillestar mjekësor të personave të ndaluar të zbatohen me rigorozitet në praktikë”.***

Në rastet e trajtimit shëndetësor më të specializuar, me rekomandimin e mjekut, personat e ndaluar/arrestuar shoqëroheshin menjëherë për në Qendrën Spitalore Rajonale Lezhë.

Në ambientin e sigurisë ndodhej edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët privatë, e cila shërbente njëkohësisht edhe për marrjen në pyetje të këtyre personave nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave, por brenda saj **nuk** ishte instaluar sistemi audio-viziv për vëzhguar veprimet e policisë me personat e ndaluar/arrestuar, si dhe për të parandaluar çdo kundërveprim të tyre ndaj punonjësve të policisë.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me sistemin e kamerave përgjatë 24 orëve. Ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë dy javore.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Në kohën e inspektimit, në ambientet e sigurisë ndodhej 1 person i arrestuar, në pritje të vlerësimit të masës së sigurisë nga gjykata.

Nga intervista me personin e arrestuar, ai nuk paraqiti asnjë ankesë për keqtrajtime nga punonjësit e policisë gjatë procesit të marrjes në pyetje, si dhe nga punonjësit e shërbimit në ambientin e sigurisë.

Nga verifikimi i librit të ankesave dhe kërkesave, u evidentua se nuk kishte asnjë ankesë apo pretendim për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike nga punonjësit e policisë.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr. 189, datë 15.03.2017 *“Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar*

deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej dhe shërbehej nga një subjekt privat që ushtronte aktivitetin brenda territorit të Komisariatit të Policisë Lezhë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve, u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë nuk ka ambiente ajrimi për persona të ndaluar/arrestuar siç parashikohet në Kreun VI, pika 1.14 të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 *“Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, ku thuhet se: *“Personi i ndaluar/arrestuar mund të dalë në ajrim sipas mundësive dhe kushteve që kanë ambientet e dhomave të sigurisë, por jo më pak se dy orë në ditë (për ato ambiente sigurie që nuk plotësojnë kushtet për ajrim e ndriçim të plotë natyral)”*.

Në vijim, nga intervista me personin e arrestuar që ndodhej në momentin e inspektimit, u evidentua se ishte furnizuar me detergjentë, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, si kusht për mbajtjen pastër të higjienës personale, ambientit të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Nga biseda me personin e arrestuar në këto ambiente ankesat kryesore ishin për mungesën e ajrimit.

Sjellim në mënyrë të përsëritur në vëmendjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit se në Komisariatin e Policisë Lezhë **nuk kishte ambiente ajrimi**.

Kjo problematikë është konstatuar edhe në Raportin e CPT-së gjatë vizitës në datat 4-15 Maj 2023. Në këtë raport kërkohet në mënyrë të përsëritur¹³ ndër të tjera: *“Të gjitha ambientet e policisë të vizituara, përfshirë edhe qendrën e re të paraburgimit në Shkodër, vuajnë një mangësi të madhe strukturore, përkatësisht mungesën e një oborri të jashtëm ushtrimesh. Si rezultat, personat e ndaluar ende nuk kishin mundësi të dilnin në ajrim. CPT-ja përsërit rekomandimin e saj që të gjithë personat e ndaluar në një institucion policor për 24 orë ose më shumë t’u ofrohet ushtrime në natyrë në baza ditore...”*¹⁴.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisariatin e Policisë Lezhë, u evidentua se zbatoheshin kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, dhe procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e Policisë”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, ku parashikohet

¹³ Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019). Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>

¹⁴ Raporti drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023, pika 34, fq. 14. Për më shumë shiko: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://rm.coe.int/1680ae233b>

se: “Çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi e sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës”.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Lezhë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” konform me procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistrë nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 4 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësi i policisë së zyrës së informacionit¹⁵.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën që në momentin e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë.

Avokati i Popullit ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vihet ora e mbikëqyrjes policore dhe jo ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit. Kjo merr më shumë vlerë pasi ky komisarjat shërben edhe si ambient sigurie për komisarjatet e tjera që nuk kanë dhoma të tilla.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht në nenet 144, 250 dhe 259 të tij, si dhe në nenin 19, pika 4 e ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Në këtë Komisarjat mbahej një regjistrë për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se përgjatë vitit 2025 ishin të shoqëruar 14 të mitur në konflikt me ligjin¹⁶.

¹⁵ Kreu VII, procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

¹⁶ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, por gjatë vitit 2025 nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë nga ana e këtyre personave.

Në Komisaratin e Policisë Lezhë u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin mbrojtës dhe prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, si dhe regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor në funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e intervistimit

Në ambientin e sigurisë të Komisarimit të Policisë Lezhë kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takim me avokatët. Kjo dhomë **nuk** ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave.

Shtetasit e shoqëruar, para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe të futeshin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Në lidhje me ambientet e intervistimit, Avokati i Popullit në zbatim edhe Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues CPT-ja, ka rekomanduar në vijimësi marrjen e masave për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Nga inspektimet periodike që zhvillon MKPT-ja në Drejtoritë dhe Komisarimet e Policisë, konstatohet se ky rekomandim nuk është plotësuar¹⁷.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar të arrestuar/ndaluar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga vetë punonjësit e policisë së shtetit, ashtu dhe nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve.

¹⁷ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”.

Gjithashtu në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit¹⁸ ku citohet se: *“Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.*

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.

CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Në Komisaratin e Policisë Lezhë, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 84/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, si dhe në Kreun VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të cilat u verifikuan gjatë intervistimit me personin e arrestuar nga grupi i inspektimit.

Gjatë inspektimit, rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga ana e punonjësit të policisë mbahej edhe një procesverbal tip i emërtuar *“Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”*.

Gjithashtu nga mbikëqyrja e fashikullit të dosjes për persona të shoqëruar ndaluar/arrestuar, u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhorë, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, ofrohet dhe ndihmë juridike duke siguruar një avokat kryesisht, duke krijuar mundësinë për të kontaktuar me të. Koha më e zgjatur në marrjen e kontaktit të personit të privimit lirisë me avokatin ishte afërsisht 3 orë.

¹⁸ Electronic recording of police interviews (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

Përgjatë inspektimit në Komisaratin e Policisë Lezhë, **u konstatua se nuk kishte një listë të afishuar në ambientet e komisarariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht, si dhe nuk ishte evidentuar në regjistrin e informacionit nëse avokatët kishin qenë të pranishëm.** Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

CPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Gjithashtu gjatë vizitës në organet e Policisë së Shtetit CPT ka konstatuar se: *“Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”*¹⁹.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut, i cili sigurohej nga Bashkia Lezhë, por edhe në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të qytetit.

Gjithashtu, u evidentua se në mjedisin e shoqërimit mungonte edhe lista e psikologëve e miratuar nga Urdhri i Psikologut në Tiranë. **Mekanizmi Kombëtar kërkon që avokati dhe psikologu të jenë të pranishëm, që në momentin e hyrjes të të shoqëruarve në komisarariat,** për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre dhe mbështetje psikologjike në rrethanat në të cilat këta shtetas ndodhen në institucion.

Grupi i monitorimit konstatoi se, vizitat mjekësore nga ana e mjekut part-time kryheshin brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*²⁰.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Nga informacioni i marrë nga Shefi i Rendit, u informuam se shërbimet shëndetësore për personat e ndaluar/arrestuar kryhen nga mjeku i emëruar me kohë të pjesshme në këtë

¹⁹ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

²⁰ Kreu V, pika 7.2 e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

institucion, i cili vinte çdo ditë, ndërsa për raste urgjente të ndaluarit/arrestuarit dërgohen në Spitalin Rajonal Lezhë.

Mekanizmi Kombëtar konstaton se mungesa e mjekut në këtë institucion ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e organikës së Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, me një mjek me kohë të plotë, pasi mund të ketë raste urgjente dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Lezhë ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ato ishin të vendosura në korridoret e këtyre ambienteve, me qëllim që të jenë të aksesueshme nga këta persona.

Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur posterat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në shqip dhe në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Nga radhët e punonjësve të policisë të këtij komisarlati, ishin trajnuar dhe specializuar 2 punonjës policie që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për ndërtimin e dhomës së shoqërimit për gra në konflikt me ligjin në Komisarlatin e Policisë Lezhë, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, vendosjen e dritareve në dhomë për futjen e ajrit dhe dritës natyrore sipas kriterëve teknike të sigurisë²¹.

²¹ Kreu VI, pika 4, procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku parashikohet se: *“Dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për persona madhorë, mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20m², secila”*.

2. Marrjen e masave të menjëhershme, për eliminimin e lagështirës në ambientet e dhomave të shoqërimit dhe atyre të sigurisë në Komisaratin e Policisë Lezhë.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar shtimin e dhomave të sigurisë me qëllim respektimin e kriterëve të hapësirës së nevojshme për jetesë për çdo person të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për zëvendësimin e dyerve me profil hekuri, me dyert me profil prej materiali druri në dhomat e shoqërimit sipas parashikimeve kreu VI pika 4.e.6.1, e.6.2, në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.
5. Marrjen e masave për parashikimin e kapaciteteve të dhomave të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit, sipas parashikimeve të standardeve të hapësirës, si dhe miratimi me urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
6. Marrjen e masave për emërimin e mjekut me kohë të plotë në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar, brenda 12 orëve të vendosjes të këtyre personave në ambientin e sigurisë.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, ndalimit/arrestimit për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
8. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e tualetit të dhomave të shoqërimit me materialet hidrosanitare dhe vendosjen e bolierit për ngrohje të ujit, i cili është i domosdoshëm për mbajtjen pastër të higjienës personale të personave të shoqëruar në këtë institucion.
9. Marrjen e masave të nevojshme për kontrollin e vazhdueshëm të zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore në të cilat merren në pyetje shtetasit, si dhe heqjen e menjëhershme të të gjitha sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.
10. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për të filluar hetimin administrativ ndaj punonjësit/ve të policisë në Komisaratin e Policisë Lezhë, të cilët me veprimet e tyre, qartazi kanë shkelur procedurat standarde që parashikon legjislacioni në fuqi, në rastet e intervistimit të të miturit në konflikt me ligjin, duke ceduar e cenuar të drejtat e fëmijës.
11. Të merren masa të menjëhershme nga Komisarati i Policisë Lezhë, për të miturit në konflikt me ligjin, për marrjen në pyetje në dhomën e intervistimit të krijuar

dhe dedikuar për këtë qëllim, në një mjedis miqësor, duke krijuar kushtet e përshtatshme sipas akteve kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të të miturve në konflikt me ligjin në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisarariatit.

12. Marrjen e masave, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, e pajisur me kamera duke kryer regjistrimin audio dhe video të procesit të marrjes në pyetje.
13. Marrjen e masave të menjëhershme, për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluar/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatët kryesisht.
14. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisarariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut, Tiranë.
15. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes së tyre në komisarariat.
16. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e ambienteve të ajrimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, për persona të ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

d.v